



BE-ja DHE KOSOVA

#WesternBalkans
#EUEnlargement

Tetor 2024



Kosova është **kandidat potencial**.



Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor

Në vitin 2023, BE shpalli **planin e rritjes** për të përshpejtuar zhvillimin socio-ekonomik të partnerëve të Ballkanit Perëndimor dhe integrimin e tyre në BE.

Plani synon të nxisë **konvergjencën socio-ekonomike** përmes integritit të zgjeruar ekonomik me **tregun unik të BE-së**, integritit rajonal brenda **tregut të përbashkët rajonal**, duke përshpejtuar reformat themelore.

Si pjesë e këtij plani të rritjes, Kosova u ftua të përgatisë **agjendën e reformave** të fokusuar në reforma që do të **çlirojnë potencialin kombëtar dhe rajonal për rritje** dhe që lidhen me çështjet themelore të procesit të zgjerimit, duke përfshirë **sundimin e ligjit, demokracinë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore**.

Zbatimin e planit të rritjes do ta mbështesë **instrumenti për reforma dhe rritje** për Ballkanin Perëndimor prej 6 miliardë eurosh. Komisioni e aprovoi agjendën e reformave të Kosovës në tetor 2024. **882 milionë euro grante të pakthyeshme dhe kredi të favorshme** do të jenë në dispozicion të Kosovës **kur** t'i përmbushë kushtet për të cilat është zotuar në agjendën e vet të reformave.

Ka një parakusht specifik për Kosovën dhe Serbinë të cilat duhet të angazhohen në mënyrë konstruktive në normalizimin e marrëdhënieve të tyre.



**Për Kosovën
BE-ja është**



partneri më i
madh tregtar



investitori
më i madh



ofruesi më i madh i
ndihmës financiare



Mbështetja e vazhdueshme e BE-së për Kosovën

BE-ja është ofruesi më i madh i ndihmës financiare për Kosovën. BE-ja ofron shumëllojshmëri të programeve dhe instrumenteve për të mbështetur zhvillimin e Kosovës dhe përafrimin me *acquis* dhe normat e BE-së.

Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA)

Ndërmjet viteve **2021-2024** BE-ja ka alokuar **mbi 245.8 milionë euro në grante të pakthyeshme** për Kosovën në kuadër të IPA III. Këto mjete mbështesin reformat themelore, zhvillimin socio-ekonomik dhe përmbushjen e standardeve dhe normave të BE-së.

Këtu përfshihen:

- **Pakoja për Mbështetjen e Energjisë prej 75 milionë eurosh** në vitin 2023, e cila ka mbështetur sektorin privat dhe familjet e cenueshme në Kosovë nga rritja e çmimeve të energjisë dhe ka përmirësuar sigurinë energjetike dhe tranzicionin e gjelbër.
- **Instrumenti i BE-së për përafrim prej 21.3 milionë eurosh** për të mbështetur perspektivën e anëtarësimit të Kosovës, duke përfshirë edhe dialogun Beograd-Prishtinë.
- Programi i BE-së për mjedisin prej **53 milionë eurosh** pi fokusuar në përmirësimin e **sistemeve për menaxhim të ujërave të zeza dhe mbeturinave solide**.

Plani Ekonomik dhe i Investimeve (PEI)

PEI i BE-së për Ballkanin Perëndimor identifikon 10 prioritet kryesore të investimeve për rajonin për të nxitur rritjen afatgjatë, për të përshpejtuar tranzicionin e gjelbër dhe digjital dhe për të nxitur bashkëpunimin rajonal.

Për projektet në **Kosovë**, prej vitit 2020, BE-ja veçse ka mobilizuar **893 milionë euro në investime falë 303 milionë euro grante të BE-së**. Fondet janë mbledhur përmes mjeteve të tilla si Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF). Këtu përfshihen:

- Kontributi i BE-së prej **55 milionë eurosh** për instalimin e një **impianti fotovoltai deri në 100 MW** dhe përdorimin e energjisë solare në rrjetin e ngrohtores së qytetit në Prishtinë.
- Ndërtimi i objektit për trajtimin e ujërave të zeza në Mitrovicë dhe **rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit që i shërben 123,000 njerëzve**.



Çka po arrijmë së bashku



27 km autostrada të ndërtuara



165 km linja hekurudhore të rehabilituara



130 MW kapacitet i instaluar për gjenerim të energjisë së ripërtëritshme




Shërbime të përmirësuara të ujësjellësit dhe kanalizimeve për **1.3 milionë njerëz**



Lidhje të ngushta për tregti dhe investime

BE-ja është partneri kryesor tregtar i Kosovës. INë vitin 2023, BE-ja ishte burim për 41.1% të tregtisë totale të mallrave të Kosovës (31.7% të totalit të eksporteve dhe 42.5% të totalit të importeve). Totali i Investimeve të Huaja Direkte të BE-së arriti në 388.9 milionë euro në vitin 2022*.

Liberalizimi progresiv i tregtisë dhe qasja e ndërsjellë pa doganë për shumicën e mallrave është duke u zhvilluar prej vitit 2006 dhe aktualisht bazohet në **Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit BE-Kosovë** (MSA).



Fotografia © EULEX



Bashkëpunimi në punët e jashtme dhe politikat e sigurisë

- Kosova vazhdon të **dënojë agresionin ushtarak të pajustificuar dhe të paprovokuar të Rusisë** kundër Ukrainës dhe të zbatojë masa kufizuese ndaj Rusisë dhe Bjellorusisë.
- Qeveria ka ndarë 100,000 euro ndihmë humanitare dhe fonde të dedikuara për strehimin e 20 gazetarëve nga Ukraina. Së voni, **Kosova ka shpallur pakot e para të ndihmës ushtarake për Ukrainën.**
- Prej vitit 2008, **Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë** (EULEX) ndihmon autoritetet e Kosovës në krijimin e institucioneve të qëndrueshme dhe të pavarura.



Kontaktet mes njerëzve

- Prej 1 janarit 2024, kosovarët përfitojnë nga **lëvizja pa viza** në BE.
- BE-ja ka financuar mbi **11,500 shkëmbime** ndërmjet qytetarëve të BE-së dhe të Kosovës në fushat e arsimit, trajnimeve, rinisë dhe sportit në kuadër të ERASMUS+ (2014-2020).

* Burimi: DG Trade

ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement
facebook.com/EUnear | x.com/eu_near

© Bashkimi Evropian, 2024

Ripërdorimi i këtij dokumenti lejohet, me kusht që të citohet në formën e duhur dhe të tregohet çdo ndryshim (licencë Creative Commons Attribution 4.0 International). Për çdo përdorim ose riprodhim të elementeve që nuk janë në pronësi të BE-së, leja mund të kërkohet direkt nga mbajtësit e të drejtave përkatëse. Të gjitha imazhet © Bashkimi Evropian, përveç nëse përcaktohet ndryshe.